



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 6.3.2023

Nr: 93

Ora: 10:00

VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E PROCEDURAVE OPERACIONALE PËR SHKATËRRIMIN E TË DHËNAVE NË PAJISJEN ELEKTRONIKE TË VOTIMIT DHE NUMËRIMIT (PEVN) DHE SISTEMI ELEKTRONIK I MENAXHIMIT TË VOTAVE DHE REZULTATEVE (SEMVR) NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, TË PËRDORURA NË ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE PËR KRYETAR BASHKIE TË DATËS 6 MARS 2022**

Në mbështetje të nenit 13, nenit 19 pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, dhe nenit 178, pika 6, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Miratimin e procedurave operacionale për shkatërrimin e të dhënave në pajisjen elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN) në memorien e brendshme të USB, dhe në Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Votave dhe Rezultateve (SEMVR) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të përdorura për votimin dhe numërimin elektronik të zgjedhësve, në zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 mars 2022, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Dokumentet e hapjes dhe mbylljes së procesit të votimit që kanë printuar pajisjet PEVN do të dërgohen në Arkivin Qendror të Shtetit së bashku me dokumentacionin zgjedhor të përcaktuar në nenin 178, pika 6 të Kodit Zgjedhor.
3. Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së ngre grupin e punës për fshirjen e të dhënave elektronike të pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit, i cili në fund të procedurës dorëzon procesverbalin ku konfirmon fshirjen e të dhënave elektronike sipas hapave të përcaktuara në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm dhe grupi i punës i ngritur sipas pikës 3 të këtij vendimi, për zbatimin e tij.

Data: 6.3.2023 Nr: 93  
Ora: 10:00



“Për miratimin e procedurave operacionale për shkatërrimin e të dhënave personale në PEVN dhe SEMVR në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, të përdorura në zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 Mars 2022”

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

**PROCEDURA OPERACIONALE PËR SHKATËRRIMIN E MATERIALEVE ELEKTRONIKE NË PAJISJET ELEKTRONIKE TË VOTIMIT DHE NUMËRIMIT ELEKTRONIK (PEVN) DHE SISTEMIN ELEKTRONIK TË MENAXHIMIT TË VOTAVE DHE REZULTATEVE (SEMVR) NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE (KQZ), TË PËRDORURA NË ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE TË DATËS 6 MARS 2022.**

Hapat që do të ndiqen për shkatërrimin e materialeve elektronike:

1. Çdo PEVN do të kthehet në gjendje fabrike duke ndjekur procedurën e reset të pajisjeve elektronike me sistem operimi android.
2. Të gjitha memorieve USB (ang.) të prodhuara gjatë zgjedhjeve të pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022 do t'u fshihet informacioni në mënyrë të përhershme nëpërmjet procesit të formatimit.
3. Serverit i cili mban rezultatet e votimit elektronik për ZAZ nr.26 (Bashkia Vorë), do t'i fshihen të dhënat e bazës së të dhënave në mënyrë të pakthyeshme duke përdorur mjetet e ofruara nga baza e të dhënave.

I gjithë procesi i shkatërrimit të të dhënave elektronike do të monitorohet nga minimumi 3 (tre) punonjës të caktuar në grup pune për këtë qëllim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.